

Përveç kësaj, lëndët në këto drejtime janë kryesisht praktike ku për bazë në vlerësim merret zhvillimi praktik i projekteve dhe aplikacioneve softuerike. Kjo formë e organizimit të lëndëve është e rëndësishme për përgatitjen e studentëve për tregun e punës, të cilët janë në gjendje të zhvillojnë edhe bizneset e veta. Po ashtu për ata është shumë e lehtë kyçja në bizneset ekzistuese. E gjithë kjo falë një stafi akademik të kualifikuar në këtë lëmi.

Stafi Akademik:

FSHK në vitin akademik 2023/24 ka në përbërje të saj 10 profesorë dhe asistentë të rregulltë, prej tyre 8 Doktorë të Shkencave dhe atë si në vijim: 6 Profesorë të Asocuar dhe 4 Asistentë. Për të kuptuar plotësisht lëndët në mësimdhënien e shkencave kompjuterike, teoria dhe praktika duhet të jenë të balancuara. Për këtë qëllim, ekzistojnë tre laboratorë të përgjithshëm kompjuterikë dhe një laborator harduerik, në të cilin mund të kryhen eksperimentet përkatëse.

Karriera / Misioni (Qëllimi):

Studentët pas përfundimit të studimeve fitojnë thirrjen akademike Bachelor në Shkenca Kompjuterike në drejtimin përkatës. Të diplomuarit e FSHK-së janë në gjendje të punojnë si inxhinierë të sistemeve softuerike, programues të web-it dhe softuerë aplikacionesh dhe menaxherë të qendrës së përpunimit të të dhënave. Ata gjithashtu do të jenë në gjendje të hartojnë dhe zbatojnë sisteme industriale ose inxhinierike me ndihmën e kompjuterëve. Në mesin e të diplomuarve tanë, një numër i konsiderueshëm janë të punësuar në kompani vendore dhe ndërkombëtare, duke ofruar shërbime teknologjike, por gjithashtu ka edhe prej tyre që janë të përfshirë në arsimimin e brezave të ardhshëm dhe duke kontribuar me hulumtime të reja shkencore.

Bashkëpunimi me universitete:

Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren është në bashkëpunim me disa universitete shtetërore në Gjermani, Suedi, Norvegji, Austri, Shqipëri, Turqi, Poloni, etj. Përveç kësaj, studentët tanë kanë mundësi të përfitojnë nga projektet si Erasmus+, Horizon 2020, si dhe në shumë projekte tjera.

Pjesëmarrja në projekte:

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike është pjesëmarrës në shumë projekte ndërkombëtare, prej të cilave mund t'i përmendim disa më me rëndësi: BESTSDI, PHDICTKES, SMART4ALL, si dhe në shumë projekte tjera. FSHK është në proces të konkurrimit edhe në projekte tjera ndërkombëtare, përmes bashkëpunimit me universitete me renome si: Linnaeus University (LNU) - Suedi, Norwegian University of Science and Technology (NTNU) - Norvegji, etj. Me projektin PHDICTKES jemi në procesin fillestar të themelimit të programit të Doktoratës në kuadër të FSHK-së.



KONTAKTI

Rruga e Shkronjave, nr. 1
20000 Prizren,
Republika e Kosovës
dekanati.shk@uni-prizren.com



Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike
Teknologji Informacioni dhe Telekomunikimi



www.uni-prizren.com



Shkurt rreth Universitetit:

Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren (UUHP) ka nisur punën në vitin 2010 pas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelimin e tij. Selia e Universitetit është në qytetin e Prizrenit, i cili është njëri nga qytetet më të lashta në Kosovë. UUHP është Universiteti i dytë publik në Kosovë. Në vitin 2010 numri i studentëve ishte afër 1,700, ndërsa tani, në vitin 2023, numri i studentëve aktiv është 5,800. Prej themelimit të tij, kanë qenë mbi 20,000 studentë në këtë Universitet. Universiteti është i akredituar nga viti 2010 dhe ofron studime në nivelin Bachelor dhe Master.

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike:

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike (FSHK) është një ndër njësitë më të rëndësishme të UUHP-së. Përmes programeve të veta të studimeve, FSHK ofron programe nga teknologjia e telekomunikimit dhe zhvillimit të softuerëve të cilat janë shumë të kërkuara në tregun lokal dhe ndërkombëtar të punës.

Studentët, në fund të studimeve, mund të përgatisin web dhe softuer produkte te gatshme për aplikim në tregun e punës. Pas përfundimit të studimeve në nivelin Bachelor, studentët mund të vazhdojnë studimet në nivelin Master, në kuadër të FSHK-së.

Plani mësimor i arsimit:

Në vitin e parë të nivelit Bachelor, studentëve u ofrohen lëndë si: Matematika, Teknologjia Digjitale, Programim, Hyrje në Rrjete, etj.

Në vitin e dytë, studentëve u ofrohen lëndë në lidhje me metodat e transmetimit, inxhiniering të softuerit, sensorët, algoritmet, pajisje kompjuterike, rrjete kompjuterike dhe koncepte të telekomunikimeve. Çdo semestër studentët kanë në dispozicion listën e lëndëve zgjedhore, prej ku mund të zgjedhin lëndët që dëshirojnë t'i ndjekin.

Në vitin e tretë, studentët përqendrohen në koncepte të avancuara të webit, telekomunikimeve, kompjutimit Cloud, si dhe në përgatitjen e temës së diplomës i cili kontribuon në zhvillimin e shkathtësive të prezantimit me shkrim dhe me gojë.

FSHK, po ashtu ofron një program në nivelin Master: Shkenca Kompjuterike dhe Teknologji Komunikimi, në të cilin program, studentët e diplomuar në drejtimin Teknologji Informacioni dhe Telekomunikimi në nivelin Bachelor, mund të vazhdojnë ngritjen e tyre profesionale dhe shkencore.



Planprogrami mësimor: Bachelor – TIT

Semestri - I	Semestri - II
Matematika 1	Algoritmet dhe strukturat e të dhënave
Programimi	Matematika II
Teknologjia digjitale	Sensorët dhe interfejsët
Hyrje në rrjete	Arkitektura e kompjuterëve dhe sistemet operative
Bazat e bartjes së informacionit	Gjuhë Angleze II për Shkenca Kompjuterike
TI dhe ndërmarrësia	Menaxhimi i informacionit
Gjuhë Angleze I për Shkenca Kompjuterike	Biznesi elektronik
Media e re dhe multimedia	Protokollet e Internetit
Semestri - III	Semestri - IV
Metodat e transmetimit	Teknologjia TCP/IP
Analiza dhe dizajnimi i orientuar në objekte	Mikrokontrollerët
Matematika diskrete	Autentifikimi dhe kriptografia
Pajisjet elektronike	Metodat e hulumtimit
Gjuhë Angleze III për Shkenca Kompjuterike	Gjuhë Angleze IV për Shkenca Kompjuterike
Interneti i gjërave dhe aplikimi i tij	Ndërveprimi njeri-kompjuter
Inxhinieria softuerike	Dizajnimi i web-it
Inteligjenca artificiale	Modelimi dhe animacioni 3D
Semestri - V	Semestri - VI
Sistemet e bazave të të dhënave	Përmbajtja dinamike e inxhinierisë së web-it
Siguria në rrjetet e TI-ve	Konceptet e telekomunikimit mobil
Teknologjia e avancuar e IP-ve dhe rrjeteve	Kompjutimi Cloud
Hyrje në gjuhët dhe teknologjitë e web-it	
Menaxhimi i kualitetit	
Mjetet për siguri në Internet	Punimi i diplomës
Finite automata dhe gjuhët formale	
Programimi për rrjete	